



KËSHILLI I BASHKISË KORÇË

VENDIM
Nr. 120 datë 03.12.2010

Për dhënien e ndihmës familjes të dëmtuar nga zjarri.

Këshilli i Bashkisë Korçë në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Sek. i Shërbimeve Komunitare dhe Emergjencave Civile, Drejtoria e Financës dhe Drejtoria Juridike, " Për dhënien e ndihmës financiare për familjen e dëmtuar", bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.206 datë 26.03.1998, i ndryshuar, " Për kriteret për pjesëmarrjen e shtetit në përballimin e detyrës në rastet fatkeqësive" Ligjin nr.8652 datë 31.07.2000 " Për organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore" neni 32, gërma dh, në ligjin nr.9936 dt. 26.06.2008. " Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë " në ligjin nr 10190 dt. 26.11.2009 " Për buxhetin e vitit 2010, Udhëzimin MF nr 1 dt. 21.01.2010 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2010" si dhe në VKB nr 20 dt 25.03.2010 " Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë dhe institucioneve të vartësisë për vitin 2010"

VENDOSI

1. Të ndihmohet familja e qytetarit Sazan Sina e cila u dëmtua nga zjarri i rënë në banesën e ndodhur në unaze në rrugë të Fajancës . Rruga .Familja ditën e aksidentit ka qënë e përbërë 1 (një) person, e konfirmuar kjo nga Zyra e Gjëndjes Civile. Masa e ndihmës për dëmin në pajisje dhe orendi do të jetë si me poshtë:

1 persona x 20 000 = **20 000 lek**

2. Ky fond do të përballohet nga fondi i emergjencave civile të miratuar në buxhetin e Bashkisë për vitin 2010 me strukturë buxhetore:

00 04980 05 Art. 6061041 Vlerë 20 000 lek

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës Sek. Shërbimeve Komunitare dhe Emergj.Civile dhe Drejtoria Juridike.

5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes.

KRYETARI

Gjergji PENDAVINJI

